

V E N D I M
Nr. 96, datë 21.3.2002

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SELISË SË SHENJTË PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA

Në mbështetje të neneve 10 pika 5 e 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SELISË SË SHENJTË PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE RECIPROKE

Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë, duke pasur dëshirën e përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar, në frymën e miqësisë, marrëdhëniet ekzistuese midis tyre,

dhe me qëllim për të rregulluar përmes një marrëveshjeje të përbashkët statusin juridik të Kishës Katolike në Shqipëri,
bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Republika e Shqipërisë garanton lirinë për të shpallur dhe praktikuar në publik Fenë Katolike. Kisha Katolike në Shqipëri ka të drejtë të organizohet dhe të plotësojë misionin e saj.

Neni 2

Republika e Shqipërisë njeh zotësinë juridike të personave ligjore për entitete të tilla të Kishës Katolike, të cilat janë të parashikuar në të Drejtën Kanonike, si arqidioqezat, dioqezat apo administratat apostolike, famullitë, bashkësitë fetare, misionet, shoqatat, seminarët, shkollat dhe institucionet arsimore të të gjitha niveleve, institucionet shëndetësore, mbas regjistrimit të tyre nga organet e drejtësisë.

Neni 3

Selia e Shenjtë dhe Kisha Katolike në Shqipëri gëzojnë lirinë e plotë të komunikimit dhe të korrespondencës me njëra-tjetrën.

Selia e Shenjtë dhe Republika e Shqipërisë do të mbajnë marrëdhëniet diplomatike në nivelin e Munciaturës Apostolike dhe Ambasadës.

Neni 4

Kisha Katolike ka të drejtë të posedojë mjete të veta të komunikimit masiv dhe ka të drejtën të përdorë mjetet publike të komunikimit masiv, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Autoriteti kompetent kishtar ka të drejtë të krijojë strukturat përkatëse të Kishës, e në veçanti të krijojë dhe të modifikojë personat juridikë kishtarë, në përputhje me të Drejtën Kanonike dhe duke respektuar ligjet shqiptare.

Selia e Shenjtë është e lirë të zgjedhë një klerik në detyrën e Ipeshkvit ose të Administratorit Apostolik i cili mund të jetë dhe Ipeshkëv.

Përpara se të publikojë emërimin e Ipeshkvit apo të Administratorit Apostolik, Selia e Shenjtë, për mirësjellje dhe në konfidencë, do të informojë Presidentin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 6

Për të plotësuar përgjegjësitë që rrjedhin nga funksioni baritor, Ipeshkvi ose Administratori Apostolik ka të drejtë të ftojë në Shqipëri priftërinj, anëtarë të kongregacioneve rregulltare dhe persona laikë të cilët nuk kanë nënshtetësinë shqiptare dhe të rekomandojë kërkesën e tyre për leje për rezidencë dhe për leje për punë drejtuar autoriteteve shqiptare, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Me kërkesën formale të Ipeshkvit ose të Administratorit Apostolik, leja për rezidencë dhe leja për punë e nënkuptuar kjo për ushtrimin e aktivitetit baritor do të lëshohen kundrejt një pagese minimale sipas legjislacionit dhe rregullave shqiptare.

Neni 7

Kisha Katolike ka të drejtë të hapë dhe të drejtojë shkollat, klinikat dhe qendrat sociale të saja sipas të Drejtës Kanonike dhe në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Republika e Shqipërisë do të kthejë pronat e Kishës Katolike në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe do të asistojë reregjistrimin e tyre në emrin e Kishës Katolike në në zyrat kompetente shtetërore.

Neni 9

Në rastet e çështjeve të dyshimta, të pazgjidhura dhe të diskutueshme të cilat kanë të bëjnë me Kishën Katolike në Shqipëri në përgjithësi ose me komunitetet apo institucionet katolike në veçanti, Kisha Katolike në Shqipëri dhe autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë do të krijojnë një komision “ad hoc” të përbashkët me detyrën për të gjetur zgjidhje të pranueshme nga të dyja palët.

Neni 10

Nëse në të ardhmen do të lindin vështirësi në lidhje me dispozitat e mësipërme që do të kenë të bëjnë me interpretimin apo aplikimin e tyre, Selia e Shenjtë dhe Republika e Shqipërisë do të procedojë në marrëveshje të përbashkët për një zgjidhje miqësore.

Neni 11

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në momentin e njoftimit reciprok për plotësimin nga Palët të procedurave të tyre të brendshme të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo marrëveshje mund të zgjidhet prej secilës nga Palët që do të njoftojë Palën tjetër për vendimin e saj me shkrim. Marrëveshja do të pushojë së ekzistuari nëntëdhjetë (90) ditë mbas ditës së

njoftimit.

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren nr.63, viti 2001 në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.205, datë 24.12.2001, paragrafi i pestë në faqen 1950,

është: Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese për çështje të ndryshme, si dhe qëndrimeve të mbajtura, të cilat vlerësohen për çdo rast konkret, pasi këto vendime kanë efekte inter partes, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se nuk është qëllimi i saj të orientojë dhe të vërë detyra në një praktikë të saj më të konsoliduar për t'i dhënë kuptimin kushtetues të drejtës së individëve për një proces të rregullt ligjor.

bëhet: Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese për çështje të ndryshme, si dhe qëndrimeve të mbajtura, të cilat vlerësohen për çdo rast konkret, pasi këto vendime kanë efekte inter partes, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se nuk është qëllimi i saj të orientojë dhe të vërë detyra për Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por të krijojë dhe të konkludojë në një praktikë të saj sa më të konsoliduar, për t'i dhënë kuptimin kushtetues të drejtës së individëve për një proces të rregullt ligjor.